



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:265872

Datë: 18.02.2022

Numri i dokumentit: 02728531

P.nr. 1009/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarve Sh.Xh, të cilin, sipas autorizimit e mbronë av. Lumnije Azemi,R,R, të cilin, sipas autorizimit e mbrojnë av. Afrim Salihu dhe av. Elvira Haziri dheA,R, të cilin, sipas autorizimit e mbronë av. Hamdi Jashari, për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor, **nga neni 185, par. 1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 lidhur me nenin 31 të KPRK-së**, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II nr. 1931/2021, të datës 09.12.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 13.12.2021, mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndërsa, më 10.01.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. Sh.Xh, me nr. Personal ..., nga babai H. dhe nëna N., e gjinisë U. i lindur më 02.02.1995, me vendbanim në Gjilan, në ., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, I papunë, i gjendjes së varfër ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

2. R,R, me nr. Personal ... nga babai S. dhe nëna L., e gjinisë A., i lindur më 28.02.1989, me vendbanim në Gjilan, në ., i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer Fakultetin e Fizioterapisë, fizioterapeut, i gjendjes së mesme ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

3. A,R, me nr. Personal ... nga babai S. dhe nëna L., e gjinisë A., i lindur më 07.05.1995, me vendbanim në Gjilan, në ., i pamartuar, ka të kryer Fakultetin e Radiologjisë, I papunë, gjendjes së mesme ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

JANË FAJTORË

Sepse, më datë 20.11.2021, rreth orës 23:00 min., në rrugën “.”, në kafiterinë “.” në Gjilan, kanë lënduar lehtë të dëmtuarin E. K., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje verbale rreth muzikës që i dëmtuari kishte lëshuar si DJ atë mbrëmje, fillimisht, përderisa i dëmtuari ishte në një tavolinë me të akuzuarin Sh.Xh, ka ardhur i akuzuari R. , i cili e ka përzënë nga tavolina të dëmtuarin E. cili është larguar në një tavolinë tjetër, por, pastaj, Sh. përsëri e ka ftuar, por, i dëmtuari nuk ka shkuar, për çka, Sh., i revoltuar ka shkuar te tavolina e tij, e ka kapur për qafe, i ka bërtitë dhe sharë me familje dhe e ka goditur me dorë, pastaj, kanë ndërhyrë edhe të akuzuarit R. dhe A., të cilët poashtu, të cilët, poashtu e kanë goditur me duar në kokë dhe shpinë, e që si pasojë e këtyre goditjeve, i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore, që, që evidnetohen në raportin mjeksor nr. 23713 të dt. 20.11.2021, që sipas ekspertizës mjeko-ligjore konstatohen si dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin,

-me çka kanë kryer vepër penale **Lëndimi i lehtë trupor**, nga **neni 185 parag. 1 nënpar. 1.4 lidhur me nenin 31** të KPRK-së, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së.

I G J Y K O N ME DËNIM GJOBE

1. të akuzuarin **Sh.Xh**,

me **Dënim Gjobe**, në shumë prej **1000 (një mijë) €**, të cilin dënim është i obliguar t'a paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, në të kundërtën, dënimi i përmendur do t'i shndërrohet në dënim burgu, duke llogaritur për çdo 20 €, një ditë burgu dhe

2. të akuzuarin **R,R**,

me **Dënim Gjobe** në shumë prej **1000 (një mijë) €**, të cilin dënim është i obliguar t'a paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, në të kundërtën, dënimi i përmendur do t'i shndërrohet në dënim burgu, duke llogaritur për çdo 20 €, një ditë burgu dhe

3. të akuzuarin A,R ,
me Dënim Gjore në shumë prej **1000 (një mijë) €**, të cilin dënim është i obliguar t'a paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, në të kundërtën, dënimi i përmendur do t'i shndërrohet në dënim burgu, duke llogaritur për çdo 20 €, një ditë burgu

Obligohen të tre të akuzuarit që ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga **20 (njëzetë) €**, secili veç e veç, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan,-Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr. 1931/2021, të datës 09.12.2021 kundër të akuzuarve Sh.Xh,R,R dhe A,R, për shkak të veprës penale **Lëndimi i lehtë trupor**, nga **neni 185 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31** të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtit t'i shpallë fajtorë dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Meqenëse të akuzuarit Sh.Xh,R,R dhe A,R, e kanë pranuar fajsinë për veprën penale e cila u vihet në barrë, i cili pranim është bërë pa presion, me vullnet të lirë, të njoftuar nga gjykata lidhur me pasojat dhe benefitet e pranimit të fajsisë, i cili pranim i fajsisë është në përputhje të plotë edhe me provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, si, deklarata e të dëmtuarit E. K., deklaratat e dëshmitarëve F. K., B. Sh. e K. Sh., raporti mjekësor ... i dt. 20.11.2021, lëshuar nga Spitali Regjional–Emergjncë në Gjilan, në emër të të dëmtuarit, ekspertiza mjeko-ligjore e dt. P7.12. 2021 dhe 08.12.2021, urdhëri për sekuestrimin e përkohshëm të diviarit, aktvendimi për ekzaminimin e diviarit, raporti i oficerit , i dt. 21.11.2021, fotografitë mbi natyrën e lëndimit trupor tek i dëmtuari, etj., nuk pati nevojë të shtjellohen prova të tjera.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara konform nenit 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese pati parasysh pranimin e sinqertë të fajsisë për veprën penale e cila u vihet në barrë, sjellja e mirë në gjykatë, ndërsa, si rrethana rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, peshën e veprës penale, faktin se të akuzuarit R. e A,R janë përsëritës të veprave penale, andaj, i shqiptoi një dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me qëllim që me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453, të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
P.nr.1009/2021
më datë 10.01.2022

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.